



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.1084/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Afijete Sada - Gillogjani, Ferki Xhaferi, anëtar duke vendosur përkitazi me apelet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Mert Ashikferku, Kosova Demokratik Turk Partisi – KDTP, Haki Rostana, Seugul Sahko Hoxha dhe Bener Keuds, të gjitha nga Subjekti Politik Kosova Demokratik Turk Partisi – KDTP, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**HUDHEN** te pasafatshëme apelet A.nr.1084/2021 dhe A.nr.1087/2021 te paraqitura nga Mert Ashikferku, A.nr. 1085/2021 i paraqitur nga Subjekti Politik Partia Demokratike Turke (KDTP), me seli në Prishtinë-dega në Prizren, A.nr. 1086/2021 i paraqitur nga Haki Rostana, A.nr.1088/2021 i paraqitur nga Seugul Sahko dhe A.nr.1089/2021 i paraqitur nga Bener Keuds, të gjithë kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike Turke (KDTP), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit.

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datën 05.11.2021, ka pranuar apelt A.nr.1084/2021 dhe A.nr.1087/2021 i paraqitur nga Mert Ashikferku, A.nr. 1085/2021 i paraqitur nga Subjekti Politik Partia Demokratike Turke (KDTP), me seli në Prishtinë-dega në Prizren, A.nr. 1086/2021 i paraqitur nga Haki Rostana, A.nr.1088/2021 i paraqitur nga Seugul Sahko dhe A.nr.1089/2021 i paraqitur nga Bener Keuds, të gjithë kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike Turke (KDTP), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, me të cilat është kërkuar runumërimi ne vendvotimet e lartcekura në apele.

Paneli, pas shqyrtimit të afatshmëris së apeleve, gjeti se:

**Apelet janë te pasafatshëme,**

Paneli duke vepruar konform Rregullës Nr. 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, përkatësisht në bazë të nenit 13.2 *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendosë ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim”* ka bashkuar apelet A.nr.1084/2021, A.nr. 1085/2021, A.nr. 1086/2021, A.nr.1087/2021, A.nr.1088/2021 dhe A.nr.1089/2021 dhe janë procedura si një lënë e përbashkët te udhëhequra me numrin A.nr.1084/2021.

Paneli, vlerëson së në këtë fazë të procesit zgjedhor kur janë dorëzuar apelet në PZAP, me pretendime nga ankuesi, që të urdhërohet KQZ-ja, që të bëjë rinumërimi e votave ne Vendvotimet e theksuara ne apele, nuk mund të procedohen si apele të afatshme, sepse për pakënaqësitë dhe parregullsitë eventuale, lidhur me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve lokale 2021, afati për të paraqitur ankesa në PZAP ka qenë deri me datë 04.11.2021, në ora 16:00, sepse KQZ-ja e ka shpallë rezultatin e këtyre zgjedhje me datë 03.11.2021, dhe afati për ankesa ka qenë 24 orë nga koha e shpalljes së këtyre rezultateve ndërsa apelet në PZAP, nga ankuesit, janë paraqitur pas afatit të lartcekur respektivisht me datë 05.11.2021, prandaj paneli nuk është lëshuar mëtej në çështje meritore për rastet e vendosura, në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar me lart, e në kuptim të nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.1084/2021 më datë 07.11.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
Adnan Konushevci



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën Supreme të Kosovës.